




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.546/2023
Datë: 27 dhjetor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.1, 1.6, 1.9, 1.14 dhe neni 27 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, neni 32 paragrafi 1 pika 1.4 dhe neni 35 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, Rregullores Nr. 04/2023 Për Ndyshimin dhe Plotësimin e Rregullores (01/2014) Për Procedurën e Ngritjes në Detyrë të Gjyqtarëve dhe Rregullores 01/2014 për procedurën e ngritjes në detyrë për gjyqtar, në vazhdimin e takimit 318-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Z. Shkelzen Sylaj, avancohet në pozitën gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme – Kolegjet e Apelit si shkallë e dytë.
- II. Z. Sylaj do të filloj punën nga data 1 janar 2024.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 dhjetor 2023.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK.nr.288/2023, të datës 28 korrik 2023, ka shpallur konkurs të brendshëm për gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, prej të cilave dy (2) për shkallën e parë dhe një (1) pozitë për Kolegjet e Apelit si shkallë e dytë e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Paneli për Shqyrtimin e Aplikacioneve dhe Intervistim, i ka rekomanduar Këshillit, 2 (dy) kandidatë, për avancim në pozitën gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme – Kolegjet e Apelit si shkallë e dytë.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, pas shqyrtimit të rekomandimeve të Panelit, si dhe pas votimit të fshehtë për kandidatët e rekomanduar, në takimin e mbajtur më 27 dhjetor 2023, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Shkelzen Sylaj, gjyqtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme;
- Kryetari të Gjykatës Supreme;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe Arkivit.

